



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.2022

PËR

**PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË AKORDIMIT TË  
FONDEVE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE, PËR  
MARRJEN E MASAVE PARANDALUESE DHE REHABILITUESE NDAJ  
FATKEQËSIVE, NË INFRASTRUKTURËN E DËMTUAR, SI DHE  
VEPRIMTARIVE TË TJERA NË FUSHËN E MBROJTJES CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “d”, të pikës 6, të nenit 23, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (më tej AKMC), në kuadrin e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitetë dhe mbrojtjes civile, planifikon fonde përmarrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile.
2. Akordimi i fondit për AKMC-në dhe përdorimi i tij duhet të bazohet në dokumentet orientuese:
  - a) strategjia kombëtare e zvogëlimit të riskut në nivel qendror dhe vendor;
  - b) vlerësimi i riskut në nivel qendror dhe vendor;
  - c) planin kombëtar të emergjencave civile në nivel qendror dhe vendor.
3. Fondet e planifikuara, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përdoren nga AKMC-ja ose mund të transferohen te njësitetë e vetëqeverisjes vendore.
4. Fondet nga AKMC-ja përdoren:
  - a) në rastet parandalimit të risqeve të reja të fatkeqësive, zvogëlimin e atyre ekzistuese dhe menaxhimin e riskut të mbetur;
  - b) kur pasojat e fatkeqësisë shtrihen në territorin e juridiksonit të disa njësive të vetëqeverisjes vendore të më shumë se një qarku, ose pavarësisht shtrirjes territoriale të fatkeqësisë kur shkalla e dëmtueshmërisë është e madhe në jetë njerëzish apo pronën.
5. Fondet t'i transferohen njësisë së vetëqeverisjen vendore, në territorin e së cilës ka ndodhur fatkeqësia, në rastin kur:
  - a) nevojitet kryerja e shpenzimeve shtesë për përballimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë;
  - b) kostoja e ndërhyrjes tejkalon buxhetin vjetor të dedikuar për mbrojtjen civile.
6. Në rastet e transferimit të fondeve njësisë së vetëqeverisjes vendore për sigurimin e kushteve të përkohshme për jetesë të qytetarëve, si dhe shpenzime të tjera për përballimin

✓ Situatave emergjente te situatuar nga kryesoria, te hartohet dokumentacioni, i cili përmban:

- a) kérkesën e argumentuar nga kryetari i bashkisë, ku përfshihet destinacioni i përdorimit të fondit, shoqëruar me preventivat dhe projektet sipas rastit;
  - b) miratimin e kérkesës nga prefekti i qarkut, duke dhënë dhe argumente shtesë për nevojën e mbështetjes financiare.
7. Për akordimin e fondeve me destinacion marrjen e masave parandaluese mbrojtëse, të përgjigjes, rehabilituese dhe të rimëkëmbjes për infrastrukturën publike në përgjegjësi të njësive të vetëqeverisjes vendore, të hartohet dokumentacioni, i cili përmban:
- a) kérkesën për fonde shtesë të njësisë së vetëqeverisjes vendore, drejtar prefektit të qarkut;
  - b) vendimin e këshillit bashkiak, ku përcaktohet destinacioni i përdorimit të fondit të kérkuar për emergjencën civile;
  - c) projektin e zbatimit të shoqëruar me dokumentacionet përkatëse, i cili sipas rastit mund të hartohet nga subjekte shtetërore dhe private të licencuara;
  - ç) konfirmimin nga prefekti i qarkut i ligjshmërisë së vendimit të këshillit bashkiak, i shoqëruar me argumente të tjera shtesë, për mbështetjen financiare;
  - d) kérkesën e argumentuar nga prefekti i qarkut, drejtar AKMC-së, për nevojën dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjes në objektet e dëmtuara.
8. Fondet financiare të krijuara në AKMC, nga donacione të subjekteve dhe individëve të ndryshëm, për përballimin e situatave të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, të administrohen sipas akteve ligjore/nënligjore dhe të përdoren në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara sipas këtij vendimi.
9. AKMC-ja është institucioni përgjegjës për hartimin dhe miratimin e urdhraleve për akordimin e fondit për mbrojtjen civile, planifikuar në buxhetin vjetor të saj.
10. Fondet e akorduara njësive të vetëqeverisjes vendore nga fondi për mbrojtjen civile, planifikuar në buxhetin vjetor të AKMC-së, administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas destinacionit të përcaktuar në urdhrint e nxjerrë nga AKMC-ja, për këtë qëllim.
11. Prefekti i qarkut siguron dhe kontrollon zbatimin e urdhrit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe mënyrën e përdorimin e tij, sipas destinacionit të përcaktuar.
12. AKMC-ja, për fondet e akorduara për parandalimin, rehabilitimin ndaj fatkeqësive në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe për veprimtari në fushën e mbrojtjes civile, ushtron kompetencat për inspektim, sipas legjisacionit në fuqi.
13. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi njësitë e vetëqeverisjes vendore, prefekti i qarkut, ministri përgjegjës për mbrojtjen civile, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe ministritë e linjës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**